



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo unutrašnjih poslova - Ministry of Internal Affairs**

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB)  
NR. 09/2023 PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS  
DHE PËRMBAJTJES SË DOKUMENTEVE  
PUBLIKE PERSONALE**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo unutrašnjih poslova - Ministry of Internal Affairs**

---

**Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme,**

Në mbështetje të nenit 8, të ligjit Nr. 05/1 -015 për Letërnjoftim, nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit Nr.03/L-037 për Dokumentet e Udhëtimit, nenit 41, paragrafi 5, si dhe nenit 137, paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt, nenit 105, paragrafit 1, nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-064 për Patentë Shoferi, nenit 73, paragrafit 3 të Ligjit Nr.05/L-022 për Armë, nenit 11, paragrafin 1, nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe nenit 38, paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011,

Nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 09/2023 PËR PËRCAKTIMIN E  
FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË DOKUMENTEVE PUBLIKE  
PERSONALE**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është përcaktimi i formës dhe përmbajtjes së dokumenteve publike personale.

**Neni 2**  
**Përkufizimet**

1. Shprehjet dhe shkurtesat që përdoren në këtë udhëzim administrativ kanë këtë kuptim:

- 1.1. **RKS** - nënkupton Republika e Kosovës;
- 1.2. **MPB** – nënkupton Ministria e Punëve të Brendshme;

1.3. **Dokumente Publike Personale** – nënkupton letërnjoftimin, dokumentet e udhëtimit, lejeqëndrimin , patentë shoferin dhe lejen e armës;

1.4. **ISO** - nënkupton standardet sipas të cilave është përbërja e dokumenteve publike personale;

1.5. **MRZ (Machine readable zone)** - nënkupton zonën e cila lexohet me makinë elektronike;

1.6. **ONAC (ICAO)** - nënkupton Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil;

1.7. **QRC – QR** kodi është një lloj i barkodit që përdoret për të siguruar qasje të lehtë në informacione, duke përdorur pajisje të mençura ose skanerë QR;

1.8. **Çip** - nënkupton pajisjen elektronike të vendosur në dokument të identifikimit, në të cilën në formë elektronike janë të vendosura të dhënat e bartësit të dokumentit;

1.9. **Polikarbonat** –nënkupton lloj materialit termoplastik i përbërë nga disa shtresa të cilat janë të qëndrueshme ndaj temperaturave të larta , goditjeve dhe ndikimeve të jashtme;

### **Neni 3**

#### **Forma dhe përmbajtja e letërnjoftimit**

1. Letërnjoftimi përbëhet nga materiali polikarbonat dhe me dizajn grafik sipas standardeve të ICAO-së.

2. Materiali i letërnjoftimit duhet të jetë i cilësisë së lartë, në mënyrë që poseduesit t’i garantohet përdorim normal për periudhën e vlefshmërisë.

3. Dimensioani i letërnjoftimit të Republikës së Kosovës është 85.7 x 53.9 x 0.76 mm, sipas ISO standardeve.

4. Letërnjoftimi i Republikës së Kosovës përmban të dhënat si në vijim:

4.1. Stemën e Republikës së Kosovës;

4.2. Emrin e shtetit;

4.3. Emrin e dokumentit;

4.4. Simbolin e dokumentit elektronik (biometrik);

4.5 Mbiemrin;

- 4.6. Emrin;
- 4.7. Datën e lindjes;
- 4.8. Gjininë;
- 4.9. Shtetësinë;
- 4.10. Datën e skadimit;
- 4.11. Vendin e lindjes;
- 4.12. Fotografinë;
- 4.13. Nënshkrimin;
- 4.14. Numrin e qasjes në kartelë (NQK);
- 4.15. Datën e lëshimit;
- 4.16. Organin e lëshimit;
- 4.17. Numrin personal;
- 4.18. Numrin e letërnjoftimit;
- 4.19. Vendbanimin;
- 4.20. Zona e leximit me makinë (ZLM).

5. Letërnjoftimi përmban çipin, në të cilin, përveç të dhënave nga paragrafi 3.4 i këtij neni, janë të ruajtura edhe:

- 5.1 Gjurmët e gishtërinjve;
- 5.2. Adresën e vendbanimit;
- 5.3. Certifikatat elektronike;
- 5.4. QR Kodi.

## **Neni 4**

### **Forma dhe përmbajtja e dokumenteve të udhëtimit**

1. Dokumentet e Udhëtimit janë: Pasaporta e Rregullt, Pasaporta Diplomatike, Pasaporta Zyrtare, Dokument Udhëtimi për të Huaj, Dokument Udhëtimi (Konventa e 28 Korrikut 1951) dhe Dokument Udhëtimi (Konventa e 28 Shtatorit 1954).

2. Forma dhe dimensionet e dokumenteve të udhëtimit të Republikës së Kosovës janë 88 x 125 mm, kurse i hapur (88+88 x 125) mm.

3. Dokumentet e udhëtimit të Republikës së Kosovës, përmbajnë të dhënat si në vijim:

3.1. Emrin e shtetit;

3.2. Stemën e Republikës së Kosovës;

3.3. Emrin e dokumentit;

3.4. Shenjën që tregon se dokumenti i udhëtimit është elektronik;

3.5. Shënime mbi pronësinë e dokumentit të udhëtimit, si dhe udhëzimet për mbajtësin e tij.

4. Faqja e brendshme e personalizuar e pasaportës përmban të dhënat si në vijim:

4.1. Emrin e shtetit;

4.2. Llojin e dokumentit të udhëtimit;

4.3. Kodin e Dokumentit;

4.4. Kodin e shtetit;

4.5. Numrin serik të dokumentit të udhëtimit;

4.6. Mbiemrin;

4.7. Emrin;

4.8. Shtetësinë;

4.9. Datëlindjen;

4.10. Numrin personal;

- 4.11. Gjininë;
- 4.12. Vendin e lindjes;
- 4.13. Gjatësinë;
- 4.14. Ngjyrën e syve;
- 4.15. Datën e lëshimit;
- 4.16. Organin e lëshimit;
- 4.17. Datën e skadimit;
- 4.18. Nënshkrimin;
- 4.19. Fotografinë e bartësit;
- 4.20. Zona e leximit me makinë (ZLM).
- 4.21. Simbolin e dokumentit elektronik.

5. Faqet e brendshme, pas faqes së personalizuar, përmbajnë hapësirën për shënime apo vërejtje të ndonjë organi, si dhe hapësirën për viza dhe vula të organeve të shteteve të huaja.

6. Faqet e brendshme të dokumenteve të udhëtimit mbajnë numrin rendor, me përjashtim të faqes së personalizuar.

7. Shënimin e numrit të përgjithshëm të faqeve të brendshme të dokumentit.

## **Neni 5**

### **Forma dhe përmbajtja e lejeqëndrimit**

1. Lejeqëndrimi përbëhet nga materiali polikarbonat dhe me dizajn grafik sipas standardeve të ICAO-së.

2. Materiali i lejeqëndrimit duhet të jetë i cilësisë së lartë, në mënyrë që poseduesit t'i garantohet përdorim normal për periudhën e vlefshmërisë.

3. Dimensioani i lejeqëndrimit të Republikës së Kosovës është 85.7 x 53.9 x 0.76 mm, sipas ISO standardeve.

4. Lejeqëndrimi i Republikës së Kosovës përmban të dhënat si në vijim:

- 4.1. Kodin e shtetit;

- 4.2. Emrin e dokumentit;
- 4.3. Simbolin e dokumentit elektronik (biometrik);
- 4.4. Mbiemrin;
- 4.5. Emrin;
- 4.6. Vendin dhe datën e lindjes;
- 4.7. Gjininë;
- 4.8. Organin e lëshimit;
- 4.9. Shtetësinë;
- 4.10. Datën e skadimit;
- 4.11. Fotografinë;
- 4.12. Nënshkrimin;
- 4.13. Numrin e qasjes në kartelë (NQK);
- 4.14. Vendin dhe datën e lëshimit;
- 4.15. Numrin personal;
- 4.16. Numrin e lejeqëndrimit;
- 4.17. Vendbanimin;
- 4.18. Zona e leximit me makinë (ZLM);
- 4.19. Llojin e lejeqëndrimit;
- 4.20. Vërejtje.

5. Lejeqëndrimi përmban çipin, në të cilin, përveç të dhënave nga paragrafi 5.4 i këtij neni, janë të ruajtura edhe:

- 5.1. Gjurmët e gishtërinjve;
- 5.2 Adresa e vendbanimit;

5.3. Certifikatat elektronike.

5.4. QR Kodi.

## **Neni 6**

### **Forma dhe përmbajtja e patentë shoferit**

1. Patentë Shoferi përbëhet nga materiali polikarbonat dhe me dizajn grafik sipas standardeve të ICAO-së.

2. Materiali i Patentë Shoferi duhet të jetë i cilësisë së lartë, në mënyrë që poseduesit t'i garantohet përdorim normal për periudhën e vlefshmërisë.

3. Dimensioni i Patentë Shoferit të Republikës së Kosovës është 85.7 x 53.9 x 0.76 mm, sipas ISO standardeve.

4. Patentë Shoferi i Republikës së Kosovës përmban të dhënat si në vijim:

4.1. Flamurin e Republikës së Kosovës dhe kodin RKS në mes me ngjyrë të bardhë ;

4.2. Emrin e dokumentit;

4.3. Emrin e shtetit;

4.4. Mbiemrin;

4.5. Emrin;

4.6. Datën dhe vendin e lindjes;

4.7. Datën e lëshimit;

4.8. Datën e skadimit;

4.9. Organin e lëshimit;

4.10. Numrin personal;

4.11. Numrin e Patentë Shoferi;

4.12. Fotografinë;

4.13. Nënshkrimin;

4.14. Kategoritë;



- 4.15. Kategoritë dhe mjetet motorike;
- 4.16. Datën e lëshimit të kategorisë;
- 4.17. Datën e skadimit të kategorisë;
- 4.18. Vërejtjet e përgjithshme dhe sipas kategorisë;
- 4.19. Hapësirat e rezervuara për shënime të ndryshme dhe informacione të lidhura me administrimin e Patentë Shoferit;
- 4.20. QR Kodi.

## **Neni 7**

### **Forma dhe përmbajtja e lejes së armës**

1. Leja e armës përbëhet nga materiali polikarbonat, i cili duhet të jetë i cilësisë së lartë, në mënyrë që poseduesit t'i garantohet përdorim normal për periudhën e vlefshmërisë.
2. Dimensioni i lejes së armës është 85.7 x 53.9 x 0.76 mm.
3. Leja e armës i përmban të dhënat si në vijim:
  - 3.1. Stemën e Republikës së Kosovës;
  - 3.2. Emrin e shtetit;
  - 3.3. Emrin e dokumentit;
  - 3.4. Mbiemrin;
  - 3.5. Emrin;
  - 3.6. Datën e lindjes;
  - 3.7. Numrin personal;
  - 3.8. Adresa;
  - 3.9. Qyteti;
  - 3.10. Numrin e lejes;
  - 3.11. Fotografinë;

- 3.12. Marka e armës;
- 3.13. Modelin e armës;
- 3.14. Numrin serik të armës;
- 3.15. Kalibrin e armës;
- 3.16. Shtetin prodhues të armës;
- 3.17. Datë e lëshimit;
- 3.18. Datën e skadimit;
- 3.19. Shënime mbi qëllimin e përdorimit të lejes së armës;
- 3.20. QR Kodi.

#### **Neni 8**

#### **Të dhënat mbrojtëse te dokumenteve publike personale**

Dokumentet publike personale përmbajnë të dhëna dhe elemente të sigurisë për mbrojtjen nga keqpërdorimet.

#### **Neni 9**

#### **Mënyra e punimit të përmbajtjes se dokumentit**

Dokumentet publike personale personalizohen me makina laserike, me printer apo makina tjera të përshtatshme ne sisteme të sigurisë së lartë, ashtu që të dhënat personale tregojnë qartë identitetin e bartësit, si dhe të garantohet qëndrueshmëria dhe funksionaliteti elektronik për periudhën e vlefshmërisë së tyre.

#### **Neni 10**

#### **Përcaktimi dhe aprovimi i formës dhe përmbajtjes**

1. Organi kompetent i MPB-se formon komisionin për përcaktimin e formës dhe përmbajtjes (dizajnit), dhe të dhënave mbrojtëse të dokumenteve publike personale.
2. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, komisioni formohet në përbërje të ministrive përkatëse, varësisht nga lloji i dokumentit publik personal.
3. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil aprovon formën dhe përmbajtjen e dokumenteve publike personale pas rekomandimit të komisionit sipas paragrafit 1. të këtij neni.

#### **Neni 11**

#### **Dispozitat kalimtare**

1. Dokumentet publike personale të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi administrativ, vlejnë deri në datën e skadimit të tyre.

2. Dokumentet publike personale të cilat gjenden në stok , mund të vazhdojnë të lëshohen edhe pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi administrativ, deri në shpenzimin e sasisë së tyre

**Neni 12**  
**Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ, shfuqizohen: Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 18/2016 për Përcaktimin e Formës, Përmbajtjes dhe Mënyrës së Punimit të Letërnjoftimit, Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 18/2015 për Përcaktimin e Formës, Përmbajtjes, Personalizimit dhe Transportimit të Pasaportave, Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 03/2018 për Përcaktimin e Formës dhe Përmbajtjes së Patentë Shoferit të Republikës së Kosovës, neni 5, neni 6 dhe neni 7 i Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr. 20/2008 –për Përcaktimin e Formës së Formularit, Përmbajtjes, Procedurës për Pajisje me Pasaportë Diplomatike dhe Zyrtare, si dhe udhëheqjen e evidencës, neni 4 dhe neni 5 paragrafi 2, neni 6 paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr. 02/2014 për Dokumentet e Udhëtimit për të Huaj, si dhe çdo dispozitë tjetër që bije në kundërshtim me këtë udhëzim administrativ.

**Neni 13**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Xhelal SVEÇLA**

---

**Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme**

13. 12 . 2023.